



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 49, Datë 27.02.2025

MBI

**PEZULLIMIN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” SH.P.K. PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “STAVEC”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.201; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.02.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 128/5 prot., datë 26.02.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k., e licencuar për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Stavec”, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 176, datë 04.11.2020, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1765 prot., datë 15.08.2024 dhe nr. 1765/1 prot., datë 19.08.2024, ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacion për modifikimin e kësaj licence, për rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC “Stavec”, nga 6,520 MW në 8,46 MW.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 173, datë 29.08.2024, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e kësaj licence, për rritjen e kapacitetit të instaluar të këtij HEC-i nga 6,520 MW në 8,44 MW, duke iu referuar kapacitetit të instaluar që rezulton në Raportin e Oponencës Teknike të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN).
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 31.08.2024 dhe 02.09.2024). Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, ERE ka njoftuar MIE-n për fillimin e kësaj procedure me shkresën nr. 1878 prot., datë 06.09.2024.
- Brenda afatit 10-ditor të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta, është depozituar në ERE shkresa e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) sh.a. nr. 3330 prot., datë 06.09.2024, protokolluar në ERE me nr. 1765/8 prot., datë 06.09.2024, me anë të së cilës

njofton ERE-n se në kontratën shtesë koncensionare nr. 675 prot., datë 224 kol., datë 06.07.2017, kapaciteti i instaluar i HEC “Stavec” është 6520 kW dhe se pranë shoqërisë ” FTL sh.a., nuk është depozituar kontratë shtesë koncesioni për ndryshimin e kapacitetit të instaluar të HEC “Stavec”. FTL sh.a. i është drejtuar në vijim dhe vetë shoqërisë “KOKA ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k., duke depozituar në ERE këtë shkresë, e cila është protokolluar me nr. 1765/11 prot., datë 16.09.2024. Sa depozituar nga FTL sh.a. nuk afekton këtë vendimmarrje, pasi sa parashtruar në shkresën e saj, është tashmë evidentuar nga ERE në vendimin e fillimit të procedurës për modifikimin e kësaj licence. Ky qëndrim i është sqaruar dhe FTL sh.a. me shkresën e ERE-s nr. 1765/10 prot., datë 13.09.2024.

- Në përfundim të afatit të pritjes së objeksioneve apo komenteve nga palët e treta (data 09.09.2024), nuk ka rezultuar të ketë të tjera.
- ERE ka njoftuar shoqërinë “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k. për vendimin e bordit nr. 173/2024 nëpërmjet shkresës nr. 1765/4 prot., datë 29.08.2024, duke evidentuar dhe dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.
- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, janë marrë dy vendime të ndërmjetme nga bordi i ERE-s, përkatësisht:
  - Bordi i ERE-s vendosi zgjatjen me 30 ditë të afatit për vendimmarrjen mbi modifikimin e licencës së HEC “Stavec” (vendimi nr. 204, datë 27.09.2024), për të marrë qëndrimet e MIE dhe OSSH dhe për të siguruar dokumentacionin e përditësuar.
  - Më pas, me vendimin nr. 230, datë 28.10.2024, vendimmarrja u pezullua për 110 ditë, duke i kërkuar shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k. të depozitojë në ERE lejet dhe miratimet e nevojshme nga institucionet përkatëse.
- Në analizë të dokumentacionit dhe komunikimeve me institucionet përkatëse, bazuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” (neni 15, pika 4), rezulton:
  1. ***Qëndrimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) – (gërma “d”)***

*Shoqëria ka dorëzuar vetëm Raportin e Oponencës Teknike, i cili vlerëson se ndryshimet në projekt plotësojnë kushtet teknike.*

*ERE ka njoftuar MIE për procedurën e modifikimit me shkresat nr. 1878 prot., datë 06.09.2024, dhe nr. 1765/24 prot., datë 05.11.2024, por nuk ka marrë përgjigje.*

*Mungon miratimi/qëndrimi i MIE për ndryshimin e kapacitetit të instaluar, dokument thelbësor për këtë proces.*

*MIE ka kërkuar nga AKBN saktësimin e kuotave, por nuk ka një përgjigje të depozituar në ERE ne lidhje me sa ka kërkuar MIE ndaj AKBN. Nevojitet komunikim në vijim me AKBN për këtë çështje.*
  2. ***Miratimi i organeve të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit – (gërma “e”)***

*Shoqëria ka deklaruar se HEC “Stavec” është në operim prej 2021 dhe se përmirësimi i projektit ka reduktuar ndikimin mjedisor.*

*AKM ka njoftuar se shoqëria ka Deklaratë Mjedisore të vitit 2017 për HEC Stavec 1 (8,245 kW), por nuk ka sqarim nëse kjo mbulon HEC Stavec me kapacitetin e kërkuar.*

*Shoqëria nuk ka dorëzuar raportet e monitorimit, siç është deklaruar në seancën dëgjimore.*

*Mungon qëndrimi përfundimtar i AKM-së mbi vlefshmërinë e lejes mjedisore nr. 289/11 prot., datë 10.07.2013. Nevojitet vijimi i korrespondencës me AKM-në.*

**3. Miratimi i organeve për menaxhimin e burimeve ujore – (gërma “f”)**

*Shoqëria ka aplikuar për një leje të re uji më 25.09.2024.*

*AMBU ka kërkuar nënshkrimin e kontratës shtesë të koncesionit për të reflektuar ndryshimet teknike, përpara aplikimit për lejen e re.*

*Leja e re e ujit, e domosdoshme për procesin, nuk është depozituar ende. Marrja e saj varet nga finalizimi i kontratës shtesë të koncesionit. ( Cit. AMBU )*

**4. Miratimi i operatorit të rrjetit për ndryshimin e kapacitetit të instaluar – (gërma “g”)**

*Shoqëria ka kërkuar mendimin e OSSH mbi ndikimin e rritjes së fuqisë nga 6,520 MW në 8,460 MW.*

*OSSH, me shkresën nr. 1765/22 prot., datë 14.10.2024, ka deklaruar se çdo rritje e kapacitetit rrezikon stabilitetin e rrjetit, duke tejkaluar 95% të kapacitetit të tij efektiv.*

*Shoqëria është në pritje të përgjigjes për kërkesat e saj të 03.08.2024 dhe 05.11.2024 për miratimin e shtimit të kapacitetit.*

*Mungon një vendim përfundimtar nga OSSH mbi këtë modifikim.*

- Procesi i modifikimit të licencës së HEC “Stavec” mbetet i pezulluar për shkak të mungesës së miratimeve nga MIE, AKM, AMBU dhe OSSH. Nevojitet vijimi i korrespondencës me këto institucione për të siguruar dokumentacionin e kërkuar dhe për të përmbushur kërkesat rregullatore.
- Në nenin 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: *nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.*
- Për gjithë sa më sipër, duke qenë se marrja e qëndrimeve (miratimeve apo refuzimeve) të organeve kompetente si më sipër, në mënyrë specifike e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), është parakusht dhe thelbësore për marrjen e një vendimi përfundimtar nga ana e ERE-s, vlerësohet që të pezullohet afati i vendimmarrjes së bordit mbi kërkesën e shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, deri në depozitimin e qëndrimit të MIE-s, qëndrimit të AKM-së, Lejes për përdorimin e burimit ujor të ndryshuar dhe qëndrimit të “OSSH” sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të pezullojë afatin e vendimmarrjes mbi kërkesën e shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Stavec”, deri në marrjen e një vendimi nga institucionet përkatëse.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**